



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:257522

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06473241

C.nr.2021:257523

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit B. R. , nga Kaçaniku, me numër personal ..., të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat L. M. nga Ferizaj, kundër të paditurës Q. R. K. -M. P. B. , të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për çështjen kontestuese shpërblim e pagave jubilarë, pagesën e shujtave ditore dhe pagën e 13-të, jashtë seancës gjyqësore, më datën date 18.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B. R. , nga Kaçaniku, si e bazuar dhe **DETYROHET** e paditura M. P. B. e Republikës së Kosovës – Policia e Kosovës, që paditësit B. R. , në emër të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020, t’ia paguaj shumën e tërësishme prej 1,899.15€, si dhe shumën prej 158.26€, në emër të pagës jubilarë (shpërblimin e 25% te një page mesatare), në shumë të përgjithshme prej **2,057.41€**.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit lidhur shpërblimin jubilar, si e pa bazuar, si dhe kërkesa për kompensimin e shujtave ditore, për shkak se paditësi është tërhequr nga kërkesëpadia

III.OBLIGOHET, pala paditëse që kësaj Gjykate t’ia paguaj shumën prej 30€, në emër të taksës për padi, ne afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi.

IV.DETYROHET, e paditura qe paditësit t’ia paguaj shumat nga pika II e dispozitivit te këtij aktgjykimi me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 €, të

gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit të tij, me datën 17.11.2021, ka paraqitur padi kundër te paditurës Q. R. K. , M. P. B. , përmes të cilës ka kërkuar shpërblimin e pagës së 13-të si dhe shpërblimit jubilar.

Me parashtresën e datës 19.07.2023, ka bere precizimin e padisë, në kuptimin objektiv, me anë të cilës ka kërkuar edhe shpërblimin shujtës ditore, ndërsa me parashtresën e datës 16.11.2023, ka precizuar periudhën kohore për shpërblimin e pagës se 13-të dhe atë për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe për kërkesën për shpërblimin e shujtës ditore, është tërhequr nga kërkesëpadia.

I autorizuari i paditësit, në padi dhe ne percizimet e padisë, ka theksuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura si zyrtar policor, që nga data 23.10.2000 dhe që nga ajo kohë vazhdon të jete i punësuar në këtë institucion. I njëjti ka përvojë të punës mbi 20 vite dhe ka pasur performacë të mirë, gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare dhe duke iu referuar UA nr. 02/2018, të datës 14.11.2018, i takon e drejta e shpërblimit jubilar si dhe pagën e 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020-të.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të përgatitje së çështjes për gjykim, përveç tjerash ka nxjerr Aktvendim për përgjigje në padi me të cilën e ka obliguar të paditurën që brenda afatit të caktuar të përgjigjet në padi duke i kundërshtuar po pranuar faktet e paraqitura me padi.

E paditura nëpërmjet përfaqësuesit të saj, me datë 28.02.2022, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të palejuar sepse paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme te ankimit. Ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në Vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Më tutje ka kundërshtuar edhe kërkesëpadinë e paditësit për sa i përket kompensimit të pagës së 13-të dhe shpërblimit jubilar, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pasi qe Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-1125, neni

20 par 3 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe ri rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr. 02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të.

Gjykata ka vendosur në këtë çështje juridike kontestimore jashtë seancës gjyqësore duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar fare seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses ishte qartazi e themeltë (pjesërisht e themeltë) pasi që ka bazë në dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë lidhur me shpërblimin jubilar, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 të LPK-së, sipas të cilit "Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë; atëherë do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia".

Gjithashtu, për pjesën e tërhequr të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në bazë nenin 149 LPK-së, ku është përcaktuar se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë).*

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga provat të cila i janë bashkangjitur padisë dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësit është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit për paditësin dhe atë Vërtetimi i punësimit Nr. I referencës 07/1-01SAP-P/10794, i datës 15.12.2021, ku vërtetohet fakti se paditësi ka filluar punën që nga data 23.10.2000, me pagë momentale prej 633.05€, për një muaj kalendarikë,

Gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr. 01/2021, mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të respektivisht për vitet 2018, 2019 dhe 2020, me nenin 29 paragrafi 2 të UAA nr. 02/2018 përcaktohet se 2. *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit.”*

Në rastin konkret, sipas formularëve të vlerësimit të performacës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet paditësi ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, përgjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e kaluara, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësi. Ashtu që, gjykata vlerëson se paditësi ka të drejtë që të kërkoj pagën e 13-të, duke u mbështetur edhe në dispozitat nën – ligjore respektivisht Udhëzimin Administrativ të cekur më lartë i cili në mënyrë të qartë e përcakton të drejtën e paditësit për të marrë shumat e cekura në emër të pagës së 13-të, të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu me mendimin juridik nr. 213/2023 të datës 09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës në pikën II, theksohet se *“ne kontestet nga marrëdhëniet e punës lidhur me kërkesat për shpërblim të pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të*

drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019 dhe 2020, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, i vlerësuar si më lart, për paditësin, e nga të cili rezulton paga të cilët e realizon paditësi, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019 dhe 2020, i takon shuma ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kompensimit të shpërblimit jubilar në shkallën prej 25%, të pagës mesatare për çdo vit jubilar, zbatohet neni 29 paragrafi 5 i UA nr. 02/2018, dhe neni 30 paragrafi 5 i UA nr. 01/2021, ku përcaktohet se *“Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës, pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”*.

Gjykata aprovoj kërkesat e paditësit, për shpërblimin prej 25% të pagës mesatare, ngase nga vërtetimet e punësimit, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 2000, dhe në vitin 2020, ka arritur vitin e dytë jubilar, me përvojë pune prej 20 viteve, marrë parasysh bazën ligjore të lartëcituar, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t’ia paguaj kompensimin pagës jubilarë me rastin e arritjes së çdo jubileu e në rastin konkret me arritjen e jubileut të dytë apo 20 vjetorit të punës, e me meqë nuk kemi provat se e paditura ka kompensuar paditësit, bazuar në udhëzimin administrative, gjykata e obligoi të paditurën si në pike II të dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Gjykata refuzoi kërkesën e paditësit për sa i përket shpërblimit jubilar, që ka të bëjë me shpërblim të 25%, të një page mesatare, për 10 vite përvojë pune, ngase nga vërtetimi i punësimit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka filluar punën me datë 23.10.2000 dhe vitin e parë jubilar e ka arritur në vitin 2010, e që në atë kohë dispozitat e Udhëzimeve Administrative të lart cituara nuk ishin në fuqi, bazuar edhe në qëndrimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhënë në Mendimin Juridik nr. nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, se *“në kontestet nga marrëdhënia e punës për shpërblimin e pagës jubilarë, për personelin e policisë, që kanë lindur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01./2021, personeli i policisë kanë të drejtë në shpërblim e pagës jubilarë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021”*

Gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësve për kompensimin e shujtave ditore, për shkak se paditësit me parashtrësë e ka tërhequr kërkesëpadinë lidhur me kompensimin e shujtës ditore.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës se palës paditëse e ka caktuar edhe lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, nga dita e paraqitjes se padisë e deri ne pagesën përfundimtare, në bazë të nenit 382 par 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 256/2020, i datës 01.12.2020, për kamatat.

Gjykata e obligoi palën paditëse që ta paguaj shumën prej 30€, në emër të taksës për padi sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 253 par. 4 të LPK-se, ku pala paditëse ka pasur detyrim që padisë, të ia bashkëngjis dëshminë mbi pagesën e taksës gjyqësore, konform Udhëzimit Administrative për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017.

Gjykata obligoi palën e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, konform nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 104€ në emër të përpilimit të padisë, dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 30€. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet e tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lenden në gjykatë.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Civil

C.nr. 2021:257523, datë 18.11.2024

Gjyqtari,

Burhan Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.